

Në bazë të nenit 21 të Ligjit për Planifikimin Hapësinor Nr. 04/L-174 dt. 23.08.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 22, dhe 44, të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr.05/L-031 dt.21.06.2016, nenit 17, pika “d” të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt.20.02.2008, nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, si dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 350/02-3400/24 dt.09.01.2024, të pronarit:Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje) dhe qiramarrësve Rasim Mrlaku, Valton Billali, Mehdi Zhugolli, Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka nga Prishtina me Investitor Marigona Hill, Sh.p.k.Hajvali, Rr.Dëshmorët e Gollakut, Lagja Marigona Hill, Prishtinë, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr.810188591, Rr. Enver Maloku Prishtinë, me pronar Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku dhe me persona të autorizuar Arben Fetahu, Uragan Alija dhe Rilind Kusari, Prishtinë, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit të ndërtesave shumëbanesore afariste, në kuadër të “Zonës 1” të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje”, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datë 10.07.2024, merr këtë:

V E N D I M PËR CAKTIMIN E KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore aplikuesve/pronarit: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje) dhe qiramarrësve Rasim Mrlaku, Valton Billali, Mehdi Zhugolli, Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka nga Prishtina me Investitor Marigona Hill, Sh.p.k.Hajvali, Rr.Dëshmorët e Gollakut, Lagja Marigona Hill, Prishtinë, me çertifikatë të regjistrimit të biznesit nr.810188591, Rr. Enver Maloku Prishtinë, me pronar Valton Bilalli dhe Rasim Mrlaku dhe me persona të autorizuar Arben Fetahu, Uragan Alija dhe Rilind Kusari, Prishtinë, sipas kërkesës për kushte ndërtimore 05 Nr. 350/02-3400/24 dt.09.01.2024, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për ndërtimin kompleksit të ndërtesave shumëbanesore afariste, Ndërtesa “1”, “2”, “3”, “4”, “5”, “6” dhe “7”, në kuadër të blloqeve “MI-8” dhe “MI-5” të “Zonës 1” të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje” në Prishtinë, konkretisht në kuadër të parcelave kadastrale nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165, 1239-164, 1239-168, 1239-169 dhe 1239-170, ZK Hajvali.

II. Lokacioni i kompleksit të parcelave për të cilin caktohen kushtet ndërtimore, përfshihet në kuadër të blloqeve urbane “MI-8” dhe “MI-5” të “Zonës 1” të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje” në Prishtinë, miratuar me Vendimin e Komunës së Prishtinës, 01 nr. 350/01-90646/23 dt.05.06.2023, dhe sipas këtij plani kjo zonë është e planifikuar banim i mesëm i përzier.

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit/parcelës së lartcekur sipas gjendjes, kadastrale, pronësore, faktike dhe dokumenteve të planifikimit hapësinor është:

- Numri, sipërfaqja, pronari dhe klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë për investitorin :
 - nr. 1239-172 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=26,260m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Rasim Mrlaku, Valton Bilalli dhe Mehdi Zhugolli, kualiteti i tokës ”Arë e klasës 6”;
 - nr. 1239-167 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=1,117.00m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka, kualiteti i tokës ”Arë e klasës 6”;

- nr. 1239-100 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=0,000.00m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka, kualiteti i tokës "Arë e klasës 6";
- nr. 1239-165 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=102.00m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka, kualiteti i tokës "Arë e klasës 6";
- nr. 1239-164 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=2,187.00m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka, kualiteti i tokës "Arë e klasës 6";
- nr. 1239-168 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=5,317.00m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka, kualiteti i tokës "Arë e klasës 6";
- nr. 1239-169 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=2,438.00m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka, kualiteti i tokës "Arë e klasës 6";
- nr. 1239-170 ,ZK.Hajvali, sipërfaqja S=1,566.00m², pronar: Ndërmarrja e Re Ratar Hajvali, Sh.P.K. (Qirambajtje), Qiramarrës Ali Krasniqi, Vesa Hasani, Valdrin Hasani dhe Lirim Zeka, kualiteti i tokës "Arë e klasës 6";

Sipërfaqja e parcelave kadastrale..... S=45,675.00m².

- E drejta pronësore-juridike e parcelës së lartcekur, është private, në bazë të kopjes së planit dhe certifikatës së njësisë kadastrale;
- Në kuadër të parcelave kadastrale të lartcekura nuk ka ndërtesë ekzistuese, shtëpi individuale banimore dhe ndërtesa ndihmese;
- Është tokë urbane, me infrastrukturë: rrugë, ujë, kanalizim, elektrikë, etj.;
- Terreni ka pjerrtësi në drejtimin veri-lindje dhe jug-perëndim, me disnivel ~11.7m’;
- Qasja ekzistuese e parcelave kadastrale është nga rruga ekzistuese dhe njëkohësisht e planifikuar me Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje" në Prishtinë;
- Parcela kadastrale për të cilën kërkohet caktimi i kushteve ndërtimore, shtrihet në kuadër të "zonës 1" të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje", dhe pjesërisht shtrihet në rrugën e planifikuar të Planit Rregullues të lartcekur;
- Në kuadër të perimetrit prej 50m’ të parcelës kadastrale, ka ndërtesa të larta banesore, administrative si dhe shtëpi individuale banimore;

IV. Projekti konceptual – "zgjidhja urbane" e kompleksit me ndërtesat shumë banesore afariste, e analizuar/trajtuar me këto kushte ndërtimore, përfshin trajtimin e parcelave kadastrale nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165, 1239-164, 1239-168, 1239-169 dhe 1239-170, ZK Hajvali, në kuadër të të cilave janë planifikuar gjithsejtë gjashtë ndërtesa shumë banesore afariste-ndërtesat:"1", "2", "3", "4", "5", "6" dhe "7", me etazhitet nga 2B+S+P deri 2B+S+P+5+Ph, të shtrira me fasadë gjatësore në drejtimin jug-lindor dhe veri perëndimor. Sipërfaqja ndërtimore e trajtuar me këtë zgjidhje urbane është planifikuar në ndërtesat e shtrira në bllok në tërësi sipas Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje" me anë të së cilës në kuadër të zonës1 janë planifikuar 2 blloqe ndërtimi, MI-8 me sipërfaqe ndërtimore mbitokësore 22,246m² dhe MI-5 me sipërfaqe ndërtimore mbitokësore 16,191m², në total sipërfaqe ndërtimore e përcaktuar për zonën 1 është 38,437.00m² ndërsa e planifikuar dhe e miratuar me këto kushte ndërtimore është 38, 430.70m².

V. Kushtet ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektit kryesor për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar në kuadër të parcelës ndërtimore, në kuadër të bllokut urban "MI-8" dhe "MI-5", të "Zonës"1" të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje" në Prishtinë, përcaktohen bazuar në parametrat, kriteret urbane, kushtet për ndërtim për realizimin-ndërtimin e kompleksit me ndërtesë shumë banesore dhe afariste, dhe hapësira përcjellëse, janë:

- Organizimi dhe qasja në kompleks, pozicionimi, gabaritet, etazhiteti i ndërtesës, raporti i ndërtesës me vijën rregulluese dhe ndërtimore, si dhe me distanca nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkimet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit-"zgjidhja urbane", bashkëngjitur këtij vendimi për caktim të kushteve ndërtimore;

- Parcela kadastrale e trajtuar në kuadër të “zonës 1”, për realizimin e kompleksit të ndërtesave shumëbanesore afariste, konkretisht parcelat kadastrale të trajtuara brenda vijës rregulluese, janë:
 - nr. 1239-172 ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=14,700m^2$,
 - nr. 1239-167, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=908m^2$,
 - nr. 1239-166, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=5,809m^2$,

Totali $S=21,417.00m^2$

- Parcelat kadastrale me sipërfaqen e trajtuar, në pjesën Z 1”, për realizimin e kompleksit të ndërtesës shumë banesore dhe afariste, që përfshihen në ndërtim-parcelë ndërtimore, konkretisht pjesa e parcelave kadastrale, e trajtuar jashtë vijës rregulluese, është:

- nr. 1239-172 ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=11,560m^2$ /Rrugë $2,976m^2$ /Shkolle Filllore $4,893.00m^2$ /Qendër Kulturore $14.0m^2$ /Gjelbërim $3,677.00m^2$,
- nr. 1239-167, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=209m^2$ /Rrugë $209m^2$,
- nr. 1239-166, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=879m^2$ /Rrugë $879.00m^2$,
- nr. 1239-165, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=102m^2$ /Rrugë $102m^2$,
- nr. 1239-164, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=2,187.00m^2$ /Rrugë $2,187m^2$,
- nr. 1239-168, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=5,317m^2$ /Shkollë Filllore $5,317.00m^2$,
- nr. 1239-169, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=2,438m^2$ /Qendër Kulturore $2,438.00m^2$,
- nr. 1239-170, ZK.Hajvali, sipërfaqja $S=1,566m^2$ /Gjelbërim $1,566.00m^2$,

Totali $S=24,258.00m^2$

- Specifikisht pjesët e parcelave kadastrale nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165 dhe 1239-164, ZK.Hajvali të planifikuara në rrugë janë: $2,976m^2+209m^2+879m^2+102m^2+2,187m^2=6,353.00m^2$
- Pjesët e parcelave kadastrale nr. 1239-172 dhe 1239-170 ZK.Hajvali të planifikuara në Gjelbërim: $3,677.00m^2+1,566.00m^2=5,243.00m^2$
- Pjesët e parcelave kadastrale nr. 1239-172 dhe 1239-168 ZK.Hajvali të planifikuara për Shkollën Filllore e Ciklit të Ulët: $4,893.00m^2+5,317.00m^2=10,210.00m^2$
- Pjesët e parcelave kadastrale nr. 1239-172 dhe 1239-169 ZK.Hajvali të planifikuara për Qendrën Kulturore: $14.00m^2+2,438.00m^2=2,452.00m^2$

- **Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave, jashtë vijës rregulluese, do të trajtohet sipas pikës 4.3.** bazuar në Rregullat e rregullimit të tokës, duke përfshirë parcelimin dhe ri parcelimin e parcelave kadastrale, të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje”, ku citoj “Shpronësimi i tokës ku janë paraparë hapësirat për infrastrukturë publike, sociale apo teknike realizohet me marrëveshje, tërësisht apo proporcionalisht me realizimin e ndërtesave të blloqeve, sipas sipërfaqes së përcaktuar në pjesën grafike për blloqet përkalëse”, Indeksi i sipërfaqes për ndërtim (ISN) për këtë plan rregullues është 0.82 andaj dhe kompensimi për interes publik me koeficient të ndërtimit me marrëveshje, është si në vijim:

$$S=24,258.00 \times 0.82=19,891.56m^2$$

- Me këto kushte ndërtimore në kuadër të parcelave ndërtimore, në kuadër të pjesës së blloqeve urbane MI-8 dhe MI-5, të zonës “1” të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje”, planifikohet të ndërtohen 6 (gjashtë) ndërtesa shumë banesore dhe afariste, të planifikuara me kaskada në teren të pjerrët, me sipërfaqe ndërtimore dhe etazhitet, sipas kalkulimeve dhe projekt propozimit, si në vijim:

- Ndërtesa “1”, me etazhitet $2B+S+P+5+Ph$, me sipërfaqe ndërtimore totale $S=11,289.64m^2$ / $7,297.29m^2$ mbi tokë dhe $3,992.35m^2$ nën tokë;
- Ndërtesa “2”, me etazhitet $2B+S+P$, me sipërfaqe ndërtimore totale $S=5,961.48m^2$ / $1,832.73m^2$ mbi tokë dhe $S=4,128.75m^2$ nën tokë;
- Ndërtesa “3”, me etazhitet $2B+S+P+5+Ph$, me sipërfaqe ndërtimore totale $S=11,313.95m^2$ / $7,297.33m^2$ mbi tokë dhe $S=4,016.62m^2$ nën tokë;
- Ndërtesa “4”, me etazhitet $B+S+P+5+Ph$, me sipërfaqe ndërtimore totale $S=9,941.86m^2$ / $7,285.91m^2$ mbi tokë dhe $S=2,655.95m^2$ nën tokë;
- Ndërtesa “5”, me etazhitet $2B+S+P+5+Ph$, me sipërfaqe ndërtimore totale $S=13,104.11m^2$ / $7,305.48m^2$ mbi tokë dhe $5,798.63m^2$ nën tokë;
- Ndërtesa “6”, me etazhitet $2B+S+P+5+Ph$, me sipërfaqe ndërtimore totale $S=11,142.74m^2$ / $7,305.48m^2$ mbi tokë dhe $3,837.26m^2$ nën tokë;

Total sipërfaqja ndërtimore e miratuar për bllokun “MI-8” dhe “MI-5” është $62,966.74m^2$ nga kjo $38,430.70m^2$ sipërfaqe ndërtimore mbitokësore dhe $24,536.04m^2$ sipërfaqe ndërtimore nëntokësore;

- Indeks i shfrytëzimit të parcelës kadastrale për zhvillim (KAP) të planit rregullues Administrativ 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, pika 1.5, fq.74 dhe është kategorizuar si “Sipërfaqe urbane e përgjithshme” është 50-70%, dhe sipas llogarisë kjo sipërfaqe është:

$$S=21,417m^2 \times 0.5\% - 0.7\% = 10,708.5m^2 - 14,991.90m^2 / \text{sipas planit rregullues};$$

$$S=7,490.45m^2 / 35\% / \text{sipas projekt propozimit}$$

- Koeficienti i shfrytëzimit maksimal të nëntokës (ISHPN), konkretisht shfrytëzimi i nëntokës së parcelës brenda vijës rregulluese, për vendosjen e ndërtesës në bazën-gabaritin e bodrumit, është max.80%, bazuar në planin rregullues dhe sipas llogarive kjo sipërfaqe është:

$$S=21,417m^2 \times 0.8 = 17,133.60m^2 / \text{sipas planit rregullues};$$

$$S=12,260.29m^2 / \text{sipas projekt propozimit}$$

- Koeficienti i shfrytëzimit të parcelës ndërtimore për hapësira gjelbëruese (ISGJ), bazuar në planin rregullues dhe në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01 Nr. 031-185481 dt. 14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, është 0.4 (40%), dhe përjashtimisht kur ndërtohet kulmi me gjelbërim, 0.3 (30%), me gjelbërim të lartë dhe të ultë, si dhe hapësira të organizuara për sport dhe rekreacion, dhe sipas llogarive kjo sipërfaqe është:

$$S=21,417m^2 \times 0.4 = 8,566.80m^2 / \text{e lejuar} /$$

$$S=6,525.40m^2 / 30.46\% \text{ në nivelin e tokës dhe } 2,058.17m^2 \text{ në nivelin e kulmit} /$$

- Në cilindo rast sipërfaqja minimale absorbuese e parcelës (SAP) nuk duhet të jetë më pak se 20% në raport me sipërfaqen e parcelës kadastrale për zhvillim si dhe kjo sipërfaqe nuk mund të shkëmbehet nëpërmjet të bonuseve të zonimit.

- Koeficienti i ndërtimit (ISPN) sipas Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje” në Prishtinë është max. 0.82, dhe trajtimi i sipërfaqeve ndërtimore për etazhet ndërtimore do të bëhet – llogaritet, si në vijim: **100%** për etazhet mbi kuotën ±0.00 dhe për etazhet me vëllim mbi **51%** apo së paku njëra ballore mbi nivelin e tokës - *suteren*, dhe **0%** për etazhet e nëntokës – *bodrum*. Bazuar në Planin Rregullues të Hollësishëm për blloët e ndërtimit MI-8 dhe MI-5, janë planifikuar sipërfaqet ndërtimore mbitokësore si në vijim:

$$MI-8, S=22,246 m^2:$$

$$MI-5, S=16,191 m^2:$$

- **Sipërfaqja e përgjithshme e parcelave, jashtë vijës rregulluese e planifikuar në infrastrukturë publike dhe sociale, do të trajtohet sipas pikës 4.3.** Rregullat e rregullimit të tokës, duke përfshirë parcelimin dhe ri parcelimin e parcelave kadastrale, të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje”, ku citoj “Shpronësimi i tokës ku janë paraparë hapësirat për infrastrukturë publike, sociale apo teknike realizohet me marrëveshje, tërësisht apo proporcionalisht me realizimin e ndërtesave të blloqeve, sipas sipërfaqes së përcaktuar në pjesën grafike për blloqet përkatëse”, Indeks i sipërfaqes për ndërtim (ISN) për këtë plan rregullues është 0.82 andaj dhe kompensimi për interes publik me koeficient të ndërtimit me marrëveshje, është si në vijim:

$$S=24,258.00 \times 0.82 = 19,891.56m^2$$

- Bazuar në nenin III. të Vendimit të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dt. 14.08.2016 dhe protokolluar me numrin 01 nr. 031-185481, për shkaqe të kursimit dhe eficiencës së energjisë, sipërfaqja që zë shtresa e "termoizolimit", nuk përfshihet në kalkulimin e sipërfaqes së përgjithshme ndërtimore e as në kalkulimin për taksë dhe tarifë për leje ndërtimore;
- Destinimi i shfrytëzimit të ndërtesave, të jetë ndërtim shumë banesor dhe afarizëm, si dhe me hapësira përcjellëse, si: kthina teknike, depo dhe hapësira garazhesh etj. (sipas projekt propozimit);
- Etazhiteti maksimal për bllokun urban “MI-8 dhe MI-5”, të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane “B” të Lagjes “Prishtina e Re-Zona Lindje”, është max.S+P+5+Ph.
- Distanca në mes ndërtesave do të përcaktohen në bazë të UA Nr.08/2017 – Normat teknike për planifikim hapësinor konkretisht distanca ndërmjet ndërtesave përcaktohet në bazë të tri kriterëve kyçe: diellosjes, ndriçimit natyror, privatësisë dhe sigurisë. Kriteri për diellosje është $\geq 2h$ diellosje gjatë ditës për kthina të banimit më datë 21 dhjetor. Ky kriter njëkohësisht plotëson edhe kriteret për ndriçim natyror dhe privatësi..
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit, me kthina primare në fasada është jo më e vogël se lartësia e ndërtesës më të lartë të banimit.

- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit nga çerdhet, kopshtet, shkollat dhe ndërtesat shëndetësore është jo më e vogël se 1.5 herë lartësia e ndërtesës më të lartë të banimit, në anën jugore ose juglindore. Në drejtimet e tjera të horizontit zbatohen pikat si më lartë.
- Distanca minimale ndërmjet ndërtesave të banimit në anët në të cilat nuk ka hapje primare apo ka vetëm hapje të kthinave sekondare është jo më e vogël se ≥ 4.00 m ose $=0.00$ m me kusht që të respektohen rregullat për mbrojtjen nga zjarri. Në rast së distancës të barabartë me 0.00m, vendosja e nënkalimit për automjetet për zjarr-fikje është me gjerësi ≥ 4.00 m dhe
- Çdo ndërtesë e planifikuar duhet të jetë e vendosur, me fasadën e përparme në vijën ndërtimore, respektivisht përbrenda hapësirës së kufizuar me vijën ndërtimore;
- Qasjet në kompleks të jenë nga rrugët e planifikuara të planit rregullues urban dhe rrugëve të planifikuara, sipas planit të situacionit/zgjidhjes urbane;
- Për qarkullim më të lehtë të zjarrfikësve duhet të parashihet qasje e brendshme çdo 50 m³, përkatësisht në çdo 50 m duhet të ekzistojë pasazh apo rrugë, me gjerësi min. 4.0 m;
- Në kuadër të kompleksit të parashihen edhe vend-parkimet e jashtme, shtigjet, trotualet kënde të lojërave për fëmijë, terrene sportive, mobiluar urban, etj.;
- Për çdo njësi banesore-rezidenciale të planifikohet 1.0 (një) vend-parkim, ndërsa për pjesët afariste të ndërtesës, varësisht prej destinimit, të parashihen 1 VP / 30 m² të sipërfaqes së vlefshme të shitjes;
- Parcelat ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore nuk duhet të rrethohen;
- Arkitektura-dukja e jashtme (fasada) e ndërtesave dhe materializimi i tyre, të jetë me materiale bashkëkohore dhe me masa të eficientës së energjisë, dhe ti përshtatet ambientit dhe kompleksit për rreth;
- Si dhe aplikimi i të gjithave kushteve tjera urbane dhe arkitektonike të përcaktuar në kriteret dhe parametrat urban të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje".

VI. Kompensimi me koeficient ndërtimi i pjesës së parcelave kadastrale për parcelat kadastrale nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165, 1239-164, 1239-168, 1239-169 dhe 1239-170, ZK Hajvali, me sipërfaqe $S=24,258.00m^2$, e përfshirë në hapësirë publike të planifikuar-rrugë, gjelbërim, shkollë fillore e ciklit të ulët, Institucion i edukimit të lartë dhe Qendër Kulturore, të realizohet si më poshtë: Sipas kalkulimeve në paragrafin "V", pjesa e parcelave kadastrale nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165, 1239-164, 1239-168, 1239-169 dhe 1239-170, ZK Hajvali e planifikuar në rrugë, gjelbërim, shkollë fillore e ciklit të ulët, Institucion i edukimit të lartë dhe Qendër Kulturore, do të trajtohet sipas pikës 4.3. Rregullat e rregullimit të tokës, duke përfshirë parcelimin dhe ri parcelimin e parcelave kadastrale, të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje", ku citoj "Shpronësimi i tokës ku janë paraparë hapësirat për infrastrukturë publike, sociale apo teknike realizohet me marrëveshje, tërësisht apo proporcionalisht me realizimin e ndërtesave të blloqeve, sipas sipërfaqes së përcaktuar në pjesën grafike për blloqet përkatëse", Indeksi i sipërfaqes për ndërtim (ISN) për këtë plan rregullues është 0.82 andaj dhe kompensimi për interes publik me koeficient të ndërtimit me marrëveshje, është si në vijim:

$$S=24,258.00*0.82=19,891.56m^2$$

Kjo drejtori jep PËLQIM për kompensimin me koeficient ndërtimi të pjesës së parcelave kadastrale nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165, 1239-164, 1239-168, 1239-169 dhe 1239-170, ZK Hajvali, bazuar në rregullat e përcaktuara me plan për rregullimin e tokës. Kjo procedurë e kompensimit me koeficient ndërtimi, do të realizohet bazuar në pëlqimin e konfirmuar në këtë paragraf, e i cili do të shërbejë si bazë për arritjen e marrëveshjes definitive, në mes të bashkëpronarëve të parcelave kadastrale të lartcekura dhe Komunës së Prishtinës, konkretisht Drejtorisë së Pronës të Komunës së Prishtinës.

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga bashkëpronarët dhe investitori, për arsye të ndryshme, detyron Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave shumëbanesore dhe afariste, të përcaktuara me këtë vendim për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Ndarja/parcelimi i parcelave kadastrale me nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165, 1239-164, 1239-168, 1239-169 dhe 1239-170, ZK Hajvali, do të realizohet sipas parcelës ndërtimore të bllokut urban "MI-8 dhe MI-5", të Planit Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje" në Prishtinë, të përcaktuar me vijën rregulluese me rrugët e planifikuara të planit rregullues urban, si dhe bazuar në Plani i situacionit-"zgjidhja urbane", vijës rregulluese të blloqeve urbane "MI-8 dhe MI-5", dispozitës urbanistike punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, të punuar nga gjeodeti i licencuar.

Andaj, kjo drejtori jep PËLQIM për ndarjen e parcelave kadastrale të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjdhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeodeti i licencuar.

Procedura e ndarjes të bëhet para aplikimit për leje ndërtimore për secilin grupacion, në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, sipas vendimit të kushteve ndërtimore dhe me kërkesë të pronarëve dhe investitorit, duke u bazuar edhe në, Planin e situacionit - "zgjdhja urbane" dhe "Situacioni i parcelave me vijën ndërtimore dhe rregulluese nga plani rregullues në sistemin koordinativ KosovaREF01", punuar nga kjo drejtori dhe manualit të ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar, e të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore.

VII. Bashkimi i parcelave dhe pjesëve të parcelave kadastrale nr. 1239-172, 1239-167, 1239-166, 1239-165, 1239-164, 1239-168, 1239-169 dhe 1239-170, ZK Hajvali, në pronësi private, bazuar në Planin e situacionit - "zgjdhja urbane", si dhe Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planin Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manuali i bashkimit punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, drejtorja jep PËLQIM për bashkimin e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - "zgjdhja urbane" & Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga Planin Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkim të punuar nga gjeometri i licencuar.

Procedura e bashkimit do të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore, bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operatin kadastral, të këtyre ndryshimeve.

Bashkimi të realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarëve & investitorit, si dhe bazuar në Situacioni i parcelës ndërtimore me vijën rregulluese dhe ndërtimore nga "Planin Rregullues të Hollësishëm për Tërësinë Urbane "B" të Lagjes "Prishtina e Re-Zona Lindje" në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01 dhe Manualit për bashkimin punuar nga gjeodeti i licencuar .

Mos zbatimi i kësaj procedure sipas këtij paragrafi, nga pronarët dhe investitorit, për arsye të ndryshme, obligon Drejtorinë e Urbanizmit, të rishikojë vendimin e kushteve ndërtimore, gjegjësisht anulimin e tyre.

VIII. Kycja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR "Prishtina" aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kycje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) mbiemri i aplikuesit, numri i identifikimit dhe adresa;
 - Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
 - Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
 - Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
 - Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).
- Kycja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kycje nga "Termokos" - Ngrohitorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

IX. Dokumentacioni ndërtimor/projekti kryesor, të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse për secilën fazë të projektit, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve", "Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinore, "Rregullore MMPH Nr. 03/2016 për normat minimale teknike për ndërtesat e banimit në bashkëpronësi", bazuar në "Udhëzim Administrativ Nr. 33/2007 për kushtet teknike të objekteve ndërtimore për qasjen e personave me aftësi të kufizuara", normave teknike për siguri nga zjarri si dhe normave dhe standardeve tjera për projektim të kësaj kategorie të ndërtesave, të dorëzohet në tre (3) kopje të shtypura, dhe një (1) digjitale, dhe të përmbajë:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50 m', me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;

- Situacionin-planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë;
- Situacionin-"zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore - zejtare;
- Detajet e nevojshme në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiliarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit - llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionim dhe detaje të nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro-energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;
- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01 nr. 035-174324 dt. 12.07.2016 e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik në bazë të analizave në terrenit;

